




Lajmëtar i informativ i Qytetit të Shkupit

SHKUPI

| Numër 22 | Viti IV | 16.11.2011 |

Numër
falas



**KRYQËZIM TURBO RRETHOR NË BULEVARDIN
"MITROPOLIT TEODOSIJ GOLOGANOV"**



Më parë



KRYQËZIM TURBO RRETHOR NË BULEVARDIN "MITROPOLIT TEODOSIJ GOLOGANOV"

Kryqëzimi turbo rrethor muajin e kaluar zëvendësoi kryqëzimin ndërmjet rrugëve "Mitropolit Teodosij Gologanov", "Kosturski heroi" dhe "Mito Haxhivasilev Jasmin", para Kishës katolike. Kjo zgjidhje e komunikacionit rrugor, e para e këtij lloji në Shkup, është tipar dallues i projektit kapital për zgjerimin dhe rikonstruksionin e bulevardit "Mitropolit Teodosij Gologanov" i cili filloi më 13 maj të

këtij viti. Qyteti i Shkupit përfundoi me sukses këtë projekt për vetëm pesë muaj, kurse më 7 tetor bulevardin e zgjeruar e hapën zyrtarisht për qarkullim kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski, kryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Nikolla Gruevski dhe kryetari i komunës Qendër, Vladimir Todoroviq.

- Zgjerimi i rrugës ekzistuese "Mitropolit Teodosij Gologanov" u realizua nga rruga

"Franklin Ruzvelt" deri te rruga "Kosturski heroi" (një degëzim) dhe drejt rrugës "Mito Haxhivasilev Jasmin" deri te kthesa djathtas drejt rrugës "Naroden front" (degëzimi i dytë). Rruga automobilistike është zgjeruar nga ana e djathtë në drejtim të komunës së Karposhit drejt komunës Qendër me gjatësi të përgjithshme 1.600 metra. Bulevardi i ri i formuar ka 4 korsi rrugore (nga dy në



çdo drejtim) me gjerësi të përgjithshme 13 metra. Dy kryqëzimet e reja të pajisura me semaforë, në rrugën “9. Maj” dhe në kthesën drejt rrugës “Naroden front” rregullojnë qarkullimin e automjeteve në unazën e re para Kishës katolike. Përreth unazës do të vendoset rrethim mbrojtës metalik me gjatësi 280 metra që do të garantojë sigurinë e këmbësorëve. Rruga e re automobilistike “Mitropolit Teodosij Gologanov” është asfaltuar në një sipërfaqe prej rreth 20 000 metra katror, ku shtresa e fundit e asfaltit është përgatitur me polimer i cili ngadalëson vjetërsinë e asfaltit dhe

formimin e gjurmëve nga lëvizja e automjeteve gjatë shumë viteve. Nga ana e majtë (e shikuar në drejtimin nga komuna Karposh drejt komunës Qendër) bulevardin e ndriçojnë 30 shtyllat ekzistuese për ndriçimin publik të cilat janë lyer. Në shtyllat ekzistuese janë zëvendësuar krahët për ndriçim. Nga ana e djathtë e rrugës automobilistike, janë vendosur 35 shtylla të reja ndriçimi. Nga ato 6 shtylla janë me nga dy llamba, kurse të tjerat me një llambë ndriçuese me fuqi 250 W. Ndriçimin e ri të rrugës “Mitropolit Teodosij Gologanov” e vendosën ekipet e „Magnus inzhiniering”, kurse për realizimin e tij Qyteti i Shkupit shpenzoi rreth 5,2 milion denarë. Ekipet profesionale kryen matjen e ndriçimit të ri rrugor dhe konstatuan se i plotëson standardet ndërkombëtare të përcaktuara



për ndriçim për një profil të tillë të rrugëve automobilistike – tha kryetari i Qytetit të Shkupit Koce Trajanovski, në hapjen e bulevardit të ri.

Ai shtoi se realizimi i këtij projekti kapital do të kontribuojë në një masë të madhe për zgjidhjen e problemeve në qarkullimin rrugor në territorin e qendrës së qytetit, do të rritet qarkullimi i automjeteve dhe do të zvogëlohet kohëzgjatja e udhëtimit, që do të kontribuojë edhe për mbrojtjen e ambientit jetësor.

- Duhet të theksohet se formimi i unazës së komunikacionit rrugor do të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi rritjen e sigursisë në qarkullimin rrugor në këtë pjesë të qytetit. Në zgjerimin dhe rikonstruksionin e bulevardit “Mitropolit Teodosij Gologanov” punuan ekipet e kompanisë së ndërtimit „Bauer BG”. Për rikonstruksionin



e bulevardit “Mitropolit Teodosij Gologanov” Qyteti i Shkupit shpenzoi rreth 96 milion denarë. Faza e dytë e këtij projekti kapital vazhdon me përgatitjen e projektit infrastrukturor për zgjerimin e bulevardit “Mitropolit Teodosij Gologanov” nga kryqëzimi me rrugën “Franklin Ruzvelt” deri te rruga “Moskovska”. Qyteti i Shkupit do të vazhdojë me realizimin e projekteve për zvogëlimin e kaosit në komunikacionin rrugor në qytet dhe projekti tjetër të cilit do t’i përkushtohemi është projekti për zgjerimin e rrugës “Prvomajska” – bëri të ditur kryetari Trajanovski.

Me projektin për zgjerimin dhe rikonstruksionin e bulevardit “Mitropolit Teodosij Gologanov”, rruga “9. Maj” është e hapur si rrugë me një kah, ku kjo pjesë është e pajisur me semaforë. Komunikacion rrugor me një kah është vendosur edhe në rrugën “Kosturski heroj”. Rruga “Hristo Smirnenki” mbetet e mbyllur për qarkullim, ashtu si edhe rruga “Hristo Pop Arsov”. Në të dyja rrugët po montohen shtylla mbrojtëse.

Në rrugën automobilistike të re janë kryer dy zgjerime për stacionet e autobusit. Trotualet janë të gjera 3,5 metra dhe janë shtruar me pllaka begatoni në sipërfaqe prej 8 000 metra katror.

Ujërat atmosferik në rrugën e re të zgjeruar do të derdhen në kanalizimin ekzistues atmosferik i cili është rinovuar, dhe janë vendosur 32 puseta të reja dhe 68 vend derdhje të reja për përcjelljen e ujërave atmosferik. Gjatë punëve ndërtimore për zgjerimin e bulevardit “Mitropolit Teodosij Gologanov” u

realizua harmonizimi i instalimeve nëntokësore për të gjithë pronarët, në korridore të veçanta përgjatë rrugës automobilistike.

Në pjesën e mesme të unazës me sipërfaqe 720 metra katror është vendosur rrjet hidrant me gjatësi 50 metra, është ngritur gjelbërim i ri dhe janë mbjellë 1 250 lule. Janë vendosur edhe 16 spërkatëse

pop-up për ujtitjen e sipërfaqes rrethore. Në drejtimin nga semaforët tek AMSM deri te terreni sportiv për futboll të vogël u punua në një sipërfaqe prej 2050 m² ku është vendosur rrjet hidrant me gjatësi 380 metra. Qyteti i Shkupit do të mbjellë 100 drurë të rinj përgjatë rrugës automobilistike të cilët do të ujiten me sistemin pikë për pikë.



MOS BLOKO KRYQËZIMIN

Për të rregulluar qarkullimin e automjeteve në kryqëzimin rrethor dhe që të mos vijë deri në bllokimin e komunikacionit rrugor Qyteti i Shkupit në bulevardin “Mitropolit Teodosij Gologanov” për herë të parë në Shkup vendosi shenjën e komunikacionit rrugor “Mos bloko kryqëzimin”, kurse me rrjetë është shënuar edhe rruga automobilistike.

Rruga e komunikacionit rrugor është shënuar me rrjetë me linja diagonale dhe ortogonale me ngjyrë të kuqe. Në të gjitha drejtimet drejt kryqëzimit është vendosur edhe shenja rrugore me të cilën shoferët informohen se hapësira në kryqëzim është shënuar dhe i paralajmëron që të mos e bllokojnë, gjë që ndodh shumë shpesh kur ka kaos në komunikacionin rrugor.

Përfitimi kryesor nga sinjalizimi i ri është rritja e qarkullimit dhe rritja e sigurisë në qarkullimin rrugor nëpërmjet zvogëlimit të mundësisë për karambole me automjetet që presin në kryqëzim.

RREGULLA PËR QARKULLIMIN NË KRYQËZIMIN RRETHOR

Automjetet që lëvizin në unazë kanë përparësi para automjeteve të cilat duan të hyjnë në unazë.

Figura 1: Lëvizja e mundshme e automjeteve që vijnë nga lagjja Karposh. Për lëvizje drejt Vodnos dhe Qendrës klinike shoferët janë të obliguar të marrin korsinë e djathtë rrugore (ngjyrë e kuqe), t'i lejojnë të kalojnë automjetet në unazë dhe të vazhdojnë të lëvizin nëpër korsinë rrugore të jashtme të unazës. Për lëvizje drejt qendrës së qytetit, drejt Kishës katolike përkatësisht drejt Sallës universale dhe prapa drejt lagjes Karposh, shoferët duhet të marrin korsinë rrugore të majtë (ngjyrë e verdhë), t'i lejojnë të kalojnë automjetet në unazë dhe të fillojnë të lëvizin nëpër korsinë rrugore të brendshme dhe të vazhdojnë me lëvizjen nëpër korsinë rrugore të jashtme të unazës.



Figura 2: Lëvizja e mundshme nga rruga "Mito Haxhivasilev Jasmin", nga Shtëpia botuese drejt lagjes Karposh. Shoferët mund të marrin edhe korsinë rrugore të djathtë edhe të majtë, t'i lejojnë të kalojnë automjetet në unazë dhe të vazhdojnë të lëvizin nëpër korsinë rrugore të jashtme ose të brendshme në varësi të asaj se cilën korsi rrugore kanë marrë më parë. Për lëvizjen drejt qendrës së qytetit dhe drejt Kishës katolike shoferët janë të obliguar ta marrin korsinë rrugore të djathtë (ngjyrë e kuqe) – drejt qendrës së qytetit shoferët mund të kthejnë djathtas pa hyrë në unazë përkatësisht janë të obliguar të lëvizin në korsinë e veçantë për kthim djathtas dhe t'i lejojnë të kalojnë automjetet të cilat dalin nga unaza dhe lëvizin drejt qendrës së qytetit, kurse shoferët që duan të lëvizin drejt Kishës katolike janë të obliguar t'i lejojnë të kalojnë automjetet që lëvizin në unazë, të vazhdojnë të lëvizin nëpër korsinë rrugore të jashtme të unazës dhe pastaj të kthehen djathtas nëpër rrugën me një kah "29 Noemvri". Për kthimin gjysmë rrethor përkatësisht për lëvizjen prapa drejt rrugës "Mito



Haxhivasilev Jasmin" shoferët janë të obliguar të marrin korsinë rrugore të majtë (ngjyrë e verdhë) dhe t'i lejojnë të kalojnë automjetet që lëvizin në unazë, të hyjnë në korsinë rrugore të brendshme dhe të vazhdojnë me lëvizjen nëpër korsinë rrugore të jashtme të unazës.

Figura 3: Lëvizja e mundshme nga qendra e qytetit drejt lagjes Karposh, drejt rrugës "29. Noemvri" dhe drejt rrugës "Mito Haxhivasilev Jasmin". Për lëvizjen drejt lagjes Karposh shoferët mund të marrin edhe korsinë e majtë dhe të djathtë të komunikacionit, t'i lejojnë të kalojnë automjetet në unazë dhe të vazhdojnë të lëvizin nëpër korsinë rrugore të jashtme ose të brendshme të unazës në varësi të asaj se cilën korsi kanë marrë më parë. Për lëvizjen drejt Kishës katolike, shoferët janë të obliguar të marrin korsinë rrugore të djathtë (ngjyrë e kuqe), t'i lejojnë të kalojnë automjetet në unazë, të vazhdojnë të lëvizin nëpër korsinë rrugore të brendshme në unazë dhe të kthehen djathtas drejt rrugës me një kah "29. Noemvri". Shoferët të cilët duan të lëvizin drejt rrugës "Mito Haxhivasilev Jasmin", janë të obliguar të marrin korsinë rrugore të djathtë, t'i lejojnë të kalojnë automjetet në unazë, të fillojnë të lëvizin nëpër korsinë rrugore të jashtme të unazës. E rëndësishme është të përmendet se automjetet të cilat lëvizin në unazë kanë përparësi para automjeteve që duan



të hyjnë në unazë, përkatësisht shoferët që duan të hyjnë në unazë janë të obliguar t'i lejojnë automjetet të cilat tashmë lëvizin në unazë.



RRETHIM DHE NDRIÇIM I RI PËR URËN “GOCE DELÇEV”






Më parë

Ura “Goce Delçev” u pajis me rrethim të ri mbrojtës dhe ndriçim të ri. Rrethimi mbrojtës i vjetër u demontua në gjatësi prej 600 metra (4 herë nga 150 metra) dhe u vendos rrethim i ri i përgatitur nga profile tubash.

- Rrethimi mbrojtës përbëhet nga 148 elementë montues me gjatësi prej 3,6 metra dhe lartësi 1,2 metra, të cilët janë lidhur me shtyllëza. Shtyllëzat janë të larta 135 centimetra dhe kanë mbështjellje dekorative alumini. Rikonstruksionin e rrethimit mbrojtës të urës „Goce Delçev” e realizuan ekipet e firmës ndërtimore „Bauer BG”, kurse për këtë projekt Qyteti



i Shkupit shpenzoi rreth 30 milion denarë. Në rrethimet e jashtme të urës janë montuar 26 kandelabra, nga 13 në çdo anë. Në 20 kandelabra është vendosur nga një llambë në formë topi, kurse në gjashtë prej tyre (në këndet dhe mesin e urës) janë vendosur nga 5 llamba në formë feneri. Këto llamba janë me ngjyrë të verdhë dhe do të shfrytëzohen për ndriçimin dekorativ dhe për ndriçimin e trotuareve. Në dhjetë shtyllat me gjatësi 10-të metra deri te shtyllat e brendshme të urës janë vendosur llamba të reja moderne, në konzula dekorative.



Shtyllat janë lyer në harmoni me ngjyrën e rrethimit mbrojtës dhe të kandelabreve – tha kryetari i Qytetit të Shkupit Koce Trajanovski.

Ai shtoi se për ndriçimin e trupit të urës janë zëvendësuar edhe llambat e neonit ekzistuese dhe jofunkionale dhe janë vendosur të reja, 152 llamba neoni me ngjyrë të verdhë.

Për ndriçimin ambiantal të kontureve të urës në urë janë vendosur 76 reflektorë POWER LED 3,5W të cilët mundësojnë që të vijë në shprehje ngjyra e artë e ndritshme e shtyllëzave të rrethimit të urës. Për ndriçimin e urës „Goce Delçev“ u kujdesën ekipet e „Elektra-komerc“ Shkup, kurse për realizimin e kësaj pjese të projektit ndau 3,7 milion denarë.



NË SHUTO ORIZARE

U RINOVUA RRUGA “PELAGONIJA”



Më parë

Ekipet e Qytetit të Shkupit muajin e kaluar rinovuan rrugën “Pelagonija”, në komunën Shuto Orizare. Gjatë punës ndërtimore u mënjanua shtresa e vjetër dhe e dëmtuar e asfaltit, u shtrua tampon i ri, dhe pastaj edhe asfalt i ri. Rruga automobilistike u rinovua në gjatësi 550 metra, në sipërfaqe prej 2 439 metra katror.

- Për shkak të gjendjes së keqe të kësaj pjese të rrugës “Pelagonija” vendosëm që ajo të jetë prioritet dhe e rinovuam. Ne do të vazhdojmë të realizojmë projekte në këtë pjesë të qytetit për të përmirësuar jetën e qytetarëve. Me këtë punë ndërtimore u rinovuan rreth 550 metra nga rruga “Pelagonija”, për të cilën Qyteti i Shkupit

ndau 3,2 milion denarë – tha kryetari Trajanovski.

Në këtë vepër ndërtimore u riparuan edhe bordurat e rrugës, kurse pusetat e kanalizimit u niveluan. Punët ndërtimore i realizoi ndërmarrja publike “Rrugë dhe rrugica”.



Më parë

U RINOVUA PJESA E PARË E RRUGËS "KOZLE"

Qyteti i Shkupit përfundoi fazën e parë të rikonstruksionit të rrugës "Kozle", në komunën Karposh. Në këtë fazë të punëve ndërtimore janë rinovuar 444 metra nga rruga, në drejtimin nga stacioni i fundit i autobusit me numër 57 deri në kryqëzimin me rrugën Jurij Gagarin.

Punët ndërtimore në këtë rrugë automobilistike do të zhvillohen në tre faza dhe do të vazhdojnë në varësi të kushteve atmosferike. Nga rruga "Kozle" do të rinovohen

1.301 metra, deri te kryqëzimi me rrugën "Nereshka". Gjatë punëve ndërtimore në pjesën e parë të rrugës "Kozle" rruga automobilistike e dëmtuar u gërmua, u rinovua baza, kurse pusetat dhe vend derdhjet u niveluan. Në rrugë është shtruar shtresë e re asfalti dhe është asfaltuar një sipërfaqe prej 3 150 metra katror. Përgjatë rrugës automobilistike u vendosën bordura të reja në gjatësi prej 900 metra.

Nga të dyja anët e pjesës së rinovuar të rrugës "Kozle" janë formuar trotuare me

gjerësi të ndryshueshme nga 80 centimetra deri në 1,5 metra në varësi të objekteve ekzistuese dhe mureve mbështetëse të rrugës automobilistike. Trotuaret janë shtruar me pllaka begatoni në sipërfaqe prej 850 metra katror. Në pjesën e parë të rrugës "Kozle" u vendos edhe kanalizim i ri atmosferik (Ø 315 mm dhe Ø 500 mm) në gjatësi prej 380 metra, me vend derdhje dhe puseta revizioni, që do të sigurojë përcjelljen e pandërprerë të ujërave atmosferik.

Në rinovimin e rrugës "Kozle" punuan ekipet e kompanisë së ndërtimit „Pelagonija” – Gostivar. Për realizimin e fazës së parë të rikonstruksionit të rrugës "Kozle" Qyteti i Shkupit ndau rreth 11,5 milion denarë. Rikonstruksioni i plotë i kësaj rruge do të kushtojë rreth 26 milion denarë.


ASFALT PËR PJESËN E DYTË TË RRUGËS "VOLKOVSKA"

Në drejtimin nga qendra e vendbanimit Volkovë deri te stacioni i fundit i autobusit me numër 22, rruga "Volkovska" në fund të muajit shtator mori një pamje të re. Rruga automobilistike është zgjeruar dhe rinovuar në gjatësi 1 300 metra gjë me të cilën do të zgjidhen problemet e banorëve përreth. Pjesa e rinovuar është vazhdimi i pjesës së rinovuar të rrugës "Volkovska", nga hekurudha deri te qendra e vendbanimit Volkovë, që Qyteti i Shkupit e përfundoi vjeshtën e kaluar.

Në pjesën e dytë të rrugës "Volkovska" u riparua pjesa ku u vendos kanalizimi fekal, rruga automobilistike u zgjerua dhe tani është e gjerë 7 metra. Në një gjatësi prej 1 300 metra të kësaj rruge është shtruar shtresë e re asfalti në një sipërfaqe prej 9 216 metra katror, kurse gjatë kësaj janë shtruar rreth 2 000 ton asfalt.

Në zgjerimin dhe rikonstruksionin e pjesës së dytë të rrugës "Volkovska" punuan ekipet e NP "Rrugë dhe rrugica". Qyteti i Shkupit për realizimin e këtij projekti nga Buxheti ndau rreth 12 milion denarë.

Zgjerimi i pjesës së dytë të rrugës "Volkovska" ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi rritjen e sigurisë në qarkullimin rrugor në këtë vendbanim.



U RINOVUAN DISA RRUGË NË LAGJEN USJE

Ekipet e Qytetit të Shkupit përfunduan projektin për zgjerimin dhe rikonstrukcionin e disa rrugëve në lagjen Usje të cila para disa vitesh u gërmuan për shkak të vendosjes së rrjetit të ujësjellësit. Në dy muajt e kaluar, u punua në rrugën 1, e cila është rinovuar në gjatësi prej 400 metrash dhe gjerësi 4 metra. Është asfaltuar sipërfaqe e përgjithshme prej 1 600 metra katror.

Në lagjen Usje këto ditë u zgjeruan edhe katër rrugë – rrugët numër 2, numër 3, numër 4 dhe numër 22 me gjatësi të përgjithshme 600 metra. Gjatë kësaj është riparuar edhe gërmimi nga rrjeti i ujësjellësit të vendosur më parë. Për zgjerimin dhe asfaltimin e rrugëve në lagjen Usje, Qyteti i Shkupit ndau nga Buxheti 3,3 milion denarë. Në terren punuan ekipet e NP "Rrugë dhe rrugica".



MBYLLEN PLAZHET E QYTETIT PËR KËTË SEZON

Sezoni zyrtar i Plazhit të qytetit –Park dhe Plazhit të qytetit-Ura e gurit përfundoi. Inventari dhe pajisjet nga plazhi do të tërhiqen dhe përsëri do të vendosen në pranverë, në fillim të sezonit të ardhshëm.

Qyteti i Shkupit është i kënaqur nga shfrytëzimi i kapaciteteve gjatë këtij viti i të dyja plazheve. Një numër i madh qytetarësh dhe vizitorësh kaluan një pjesë të madhe të muajve të verës duke pushuar dhe u fladitur në bregun e lumit Vardar.

Interes të veçantë zgjuan terrenet e volejbollit të cilat ishin plot e përplot deri në orët e vonshme të mbrëmjes, gjatë gjithë sezonit. Përveç shfrytëzimit për rekreacion, në këto terrene u mbajtën edhe disa turne me kualitet në volejbol në rërë.

Plazhet e qytetit këtë sezon ishin edhe vende ku u mbajtën shumë evenimente kulturore zbavitëse.



URA NË SARAJ ËSHTË E MBYLLUR PËR QARKULLIM

Ura e hekurit në lumin Vardar në Saraj është mbyllur për qarkullim për shkak të zhvillimit të sigurt të punëve për ndërtimin e urës së re në lum. Qarkullimi rrugor në periudhën e ardhshme do të zhvillohet nëpërmjet rrugës sekondare, kurse mund të shfrytëzohet edhe unaza rreth Shkupit për hyrje në Saraj dhe në vendet përreth.

Për shkak të kushteve të vështira të rrugës Qyteti i Shkupit i njofton qytetarët dhe pjesëmarrësit e tjerë në qarkullim se duhet të jenë shumë të kujdesshëm dhe të respektojnë sinjalizimin e vendosur për zhvillimin sa më të sigurt të sinjalizimit.

PARKING I RI NË RRUGËN "VASKO KARANGELEVSKI"

Parkingu për 220 automjete u hap nga muaji i kaluar në rrugën "Vasko Karangelevski" në lagjen Aerodrom. Parkingu shtrihet në një sipërfaqe prej 2 415 metra katror, kurse për ndërtimin e tij Qyteti i Shkupit ndau 5 milion denarë.

- Qyteti i Shkupit edhe më tej do të punojë në zgjidhjen e problemit me kaosin në qarkullimin rrugor dhe hapjen e vendeve të parkimit të reja për të tejkaluar problemet me të cilat ballafaqohen qytetarët – tha kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski.

Punët ndërtimore në këtë parking i përfundoi ndërmarrja publike „Rrugë dhe rrugica”.

KOHË PUNE DIMËRORE TEK PARKIMI ZONAL

Ndërmarrja publike "Parkingu i qytetit" nga data 01.11. 2011 ndryshoi kohën e punës të parkimeve publike në të cilat është vendosur parkimi zonal. Në periudhën e dimrit, koha e punës e sipërfaqeve publike A, B dhe C në të cilat aplikohet parkimi zonal do të jetë nga ora 7 deri në orën 21, nga e hëna deri të premtën, kurse të shtunën koha e punës do të jetë nga ora 7 deri në orën 14.

Koha e punës në sipërfaqet publike D në të cilat zbatohet parkimi zonal do të jetë nga ora 7 deri në orën 23, nga e hëna deri të shtunën.

Ky ndryshim i kohës së punës organizohet për periudhën e dimrit. Të dielën dhe për festat shtetërore, parkimi në zonat e përmendura do të jetë falas.

Ndërmarrja publike "Parkingu i qytetit" i njofton qytetarët edhe se më 1 nëntor përfundoi sezoni për huazimin e biçikletave.



KREDI NGA BERZH PËR BULEVARDIN "PRVOMAJSKA" DHE PËR SISTEMIN E KONTROLLIT TË KOMUNIKACIONIT RRUGOR

Qyteti i Shkupit dhe Banka evropiane për rinovim dhe zhvillim (BERZH) më 14 tetor nënshkruan kontratë për kredi në vlerë prej 5,6 milion euro që Qyteti i Shkupit do ta shfrytëzojë për modernizimin e kontrollit të komunikacionit rrugor dhe për rikonstruksionin e rrugës "Prvomajska" një nga rrugët automobilistike kryesore në qytet. Në emër të Qytetit të Shkupit kontratën e nënshkroi kryetari Koce Trajanovski, kurse në emër të BERZH kontratën e nënshkroi Lin O'Gredi, zëvendës-drejtor për financimin e projekteve të infrastrukturës komunale.

- Tek Banka evropiane për rinovim dhe zhvillim gjetëm një partner serioz i cili njohu prioritetet për të cilat përpqemi t'i realizojmë si njësi e vetëqeverisjes lokale. BERZH përkrah modernizimin e sistemit të komunikacionit në Shkup me kredi prej 5,6 milion euro me qëllim vendosjen e sistemit modern për kontrollin e komunikacionit dhe rikonstruksionin e rrugës "Prvomajska". Kjo është hera e parë që një njësi e vetëqeverisjes lokale në Maqedoni siguron përkrahje financiare drejtpërsëdrejti nga institucion financiar ndërkombëtar, pa garanci shtetërore. Me përkrahjen dhe mjetet nga BERZH do të vendoset sistem modern për menaxhimin e komunikacionit në Shkup, të bazuar në teknologjinë informatike. Ai parashikon avancimin e komunikacionit në territorin e qytetit me futjen e kontrollit adaptues të komunikacionit nëpërmjet instalimit të kontrollorëve të rinj në rreth 70 kryqëzime, rrjet optik për lidhjen e kontrollorëve të semaforëve, aparate të reja komunikacioni, shenja për përmbajtje të ndryshueshme, kamera për mbikëqyrjen e komunikacionit, lidhjen e sistemeve ekzistuese AVL në transportin publik dhe formimin e Qendrës për menaxhimin dhe kontrollin e komunikacionit. Me kredinë nga BERZH do të financohet dhe rinovohet një nga korridoret themelore të komunikacionit rrugor në Shkup, rruga "Prvomajska",



Rruga „Prvomajska“

përkatësisht rruga do të transformohet në rrugë automobilistike me katër korsi, me trotuare të rinovuara, me korsi për biçikleta dhe sinjalizim të ri rrugor. Investimet në infrastrukturën urbane janë prioriteti kryesor për Qytetin e Shkupit. Projekti përkrah Qytetin në përkushtimin e tij për përmirësimin e kualitetit dhe sigurisë në komunikacionin rrugor. Ky partneritet i parë ndërmjet BERZH dhe Qytetit të Shkupit do të mundësojë që projekti të realizohet në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare – tha kryetari Koce Trajanovski, gjatë nënshkrimit.

Ai shtoi se implementimi i projektit është përkrahur edhe me 880 000 euro ndihmë teknike i siguruar nga Banka dhe Qeveria e Republikës së Austrisë.

Financimi nga BERZH lidhet me programin CIVITAS „Renaissance“, të financuar nga BE-ja, me të cilin u iniciua modernizimi i sistemit të komunikacionit në Shkup.

- Ky projekt do të mundësojë siguri në komunikacionin rrugor, si për shoferët ashtu edhe për këmbësorët në kryeqytetin e Maqedonisë. Kjo do të zvogëlojë kohën e udhëtimit, si dhe ndotjen. Ne jemi të kënaqur nga bashkëpunimi me Qytetin e Shkupit, në përgatitjet për këtë projekt të rëndësishëm për qytetin. Projekti do të jetë një shembull i shkëlqyer se si me kreditim të drejtpërdrejtë mund t'u ndihmohet komunave në avancimin e infrastrukturës lokale dhe shërbimeve - tha Lin O'Gredi, zëvendës-drejtor për financimin e projekteve në infrastrukturën komunale.

Fushatë

„BË NJË VEPRIM TË MENÇUR, SHFRYTËZO TRANSPORTIN PUBLIK”



„Bë një veprim të mençur, shfrytëzo transportin publik” është emërtimi i fushatës e cila do të fillojë më 13 tetor, dhe duhet të nxisë qytetarët në mënyrë më masive të shfrytëzojnë transportin publik. Fushata „Bë një veprim të mençur, shfrytëzo transportin publik” është financuar nga Qyteti i Shkupit, NQP dhe nga BIE “Makedonija soobraqaj” – AMERIT.

- Qëllimi i kësaj fushate është edukimi i publikut për të gjitha përparësitë që dalin nga shfrytëzimi i transportit publik, sepse ai është më ekonomik, më i sigurt dhe ndot më pak ambientin jetësor. Kjo fushatë përbëhet nga disa video-spote dhe afishe të cilat në periudhën e ardhshme do të emitohen në medime – tha drejtori i NQP-së, Misho Nikollov, në startin e fushatës.

Kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski u përqendrua në aktivitetet që u ndërmoren nga Qyteti i Shkupit për të përmirësuar transportin publik.

- Gjatë vitit 2011 me lëshimin në qarkullim të 80 autobusëve me dysheme të ulët dhe 68 autobusëve dykatësh është rinovuar 50% e parkut të automjeteve të NQP-së. Deri në fund të vitit 2011 do të arrijnë edhe 16 minibusë për ambientet rurale të qytetit. Presim që në vitin 2012 të arrijnë edhe 67 autobusë dykatësh dhe 16 autobusë panoramikë, kurse 67 autobusë dykatësh duhet të arrijnë edhe në vitin 2013 – bëri të ditur kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski.





U RREGULLUA ZHARDINIERI NË VLLAE

Ekipet e Qytetit të Shkupit këto ditë përfunduan rregullimin hortikulturor të zhardinierëve në bulevardin "Partizanski odredi" në drejtimin nga semaforët tek mbikalimi „Vlajko“ deri te semaforët tek Porta Vllae, me gjatësi 1 500 metra. Në zhardinierin, i cili është me sipërfaqe 2 113 metra, është mbjellur me bar. Është vendosur edhe rrjet hidrant me gjatësi 552 metra, kurse gjelbërimi do të ujitet me sistemin pikë për pikë.

Në pjesën e mesme të këtij bulevardi kishte rrethim mbrojtës prej hekuri, kurse me zëvendësimin e tij me zhardinier u përmirësua siguria në komunikacionin rrugor dhe u zbkurua dhe u gjelbërua hapësira.

Në rregullimin e zhardinierit punuan ekipet e NP „Parqe dhe gjelbërim“, kurse Qyteti i Shkupit ndau rreth 1,7 milion denarë.



AKSION PËR NDARJEN E 2 500 FIDANËVE

Qyteti i Shkupit edhe këtë vjeshtë vazhdon me aksionin tradicional për ndarjen e fidanëve për të gjithë këshillat banesor të interesuar ose bashkësitë vendore urbane. Në këtë aksion Qyteti planifikon të ndajë 2 500 fidanë (gjetherënës, gjethembajtës dhe kaçube).

Këshillat banesor dhe bashkësitë vendore urbane të interesuara dorëzojnë kërkesë për ndarjen e fidanëve deri te Sektori për punë komunale i Qytetit të Shkupit, në bulevardin "Ilinden" p.n. Subjektet në kërkesë theksojnë llojin e fidanit që kërkojnë t'u ndahet, numrin dhe vendin e saktë në të cilin planifikojnë t'i mbjellin fidanët. Në kërkesë duhet të qëndrojë vula e këshillit banesor ose e bashkësisë vendore urbane.

Këshillave banesor ose bashkësive vendore urbane të interesuara, të cilëve do t'u miratohen kërkesat, në këtë aksion do të ndahen më së shumti nga 10 fidanë.

Aksioni i Qytetit të Shkupit për ndarjen e fidanëve organizohet për të katërtin vit me radhë. Çdo vit ndahen fidanë në vlerë prej dy milion denarë, të ndara në dy etapa, në pranverë dhe vjeshtë. Ndarja e fidanëve do të vazhdojë edhe vitin e ardhshëm.



TREG I RI I LULEVE NË SHKUP



Shkupi u bë me Treg të ri të luleve, në lokacionin përballë Shtëpisë botuese. Tregu i ri i luleve është ndërtuar në sipërfaqe prej 242 metra katror dhe disponon me 16 dyqane lulesh. Dyqanet e luleve janë vendosur në platformë dhe janë vendosur në dy rreshta, nga tetë në çdo anë. Ndërtimi i shtëpizave kushtoi rreth 3 milion denarë dhe është financuar plotësisht nga qiramarrësit, kurse mjetet e investuara do t'u zbriten nga qiraja që duhet të paguajnë për ambientin që shfrytëzojnë.

Korsia ndërmjet dy dyqaneve të luleve është e shtruar me pllaka begatoni. Tregu i luleve ka energji elektrike dhe është i lidhur me rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit. Në ndërtimin e platformës për Tregun e luleve punuan ekipet e NP „Rrugë dhe rrugica“, kurse dyqanet montuese të luleve i ndërtoi firma DPTTU „Konstruktor“ nga Shkupi.

Ekipet e NP „Parqe dhe gjelbërim“ rregulluan hortikulturën e hapësirës përreth Tregut të luleve. Rreth platformës, në një sipërfaqe prej 400 metra katror është mbjellur bar, kurse në drejtimin nga bulevardi „Mitropolit Teodosij Gologanov“ do të mbillen panja.





Ekipet e NP „Rrugë dhe rrugica“ punuan në rregullimin e stacionit të autobusit me numër 23, si dhe të parkingut që do të menaxhohet nga NP „Parkingu i qytetit“. Qyteti i Shkupit për realizimin e këtij projekti, përkatësisht për ndërtimin e platformës në të cilën janë vendosur dyqanet e luleve, për parkingun para Tregut të luleve, për rregullimin e stacionit të autobusit me numër 23 dhe për parkingun me të cilin do të menaxhojë NP „Parkingu i qytetit“ nga Buxheti do të ndajë rreth 6 milion denarë.

Këshilli i Qytetit të Shkupit

NDIHMË FINANCIARE PËR VIKTIMAT E TËRMETIT NË TURQI

Këshilli i Qytetit të Shkupit në seancën e fundit miratoi ndihmë financiare për viktimat e tërmetit katastrofik që më 23 tetor goditi qytetin Van, në juglindje të Turqisë. Qyteti i Shkupit, si Qytet i solidaritetit, ndau 1,5 milion denarë (25 000 euro) ndihmë financiare për viktimat dhe për riparimin e dëmeve nga tërmeti në qytetin Van.

Qyteti i Shkupit deri tani ka ndihmuar në mënyrë altruiste për riparimin e dëmeve nga sulmi i dallgëve cunami në Indonezi, nga tërmeti në Seçuan, Kinë, nga tërmeti në Haiti, nga tërmeti në Japoni dhe për riparimin e dëmeve nga përmbytjet në Shkodër, Shqipëri.

NDËRTIMI I KANALIZIMIT FEKAL NË FSHATIN LUBOTEN

Qyteti i Shkupit merr pjesë në ndërtimin e fazës së parë të kanalizimit fekal në fshatin Luboten. Këshilli i Qytetit të Shkupit miratoi bashkëpunimin me komunën Butel për ndërtimin e rrjetit fekal, gjë me të cilën do të përmirësohen në mënyrë të ndjeshme kushtet për jetesë të banorëve.

Vlera e përgjithshme e vlerësuar e këtij projekti është 7 milion denarë, ku Qyteti i Shkupit do të marrë pjesë me 5 milion denarë, kurse komuna e Butelit me 2 milion denarë.

ZGJIDHJE PËR PROBLEMET E KOMUNIKACIONIT RRUGOR NË SHKUP

Qyteti i Shkupit vazhdon me realizimin e projekteve me të cilat do të tejkalohen problemet me infrastrukturën e komunikacionit rrugor. Si një nga projektet kryesore që do të realizohen për këtë qëllim është ndërtimi i rrugës nëntokësore në territorin e qendrës së qytetit.

Për realizimin e këtij projekti, Këshilli i Qytetit të Shkupit miratoi detyrimin me kredi të Qytetit të Shkupit nëpërmjet dhënies së fletë obligacioneve në vlerë prej 5 milion euro në kundërvlerë në denarë. Me projektin është planifikuar të ndërtohet rrugë automobilistike nëntokësore që do të lidhë bulevardin "Kuzman Josifovski - Pitu" me bulevardet "Ilinden" dhe "Partizanski odredi" gjë me të cilën do të mundësohet lidhje e drejtpërdrejtë ndërmjet pjesës lindore dhe perëndimore të qytetit. Rruga automobilistike nëntokësore do të jetë 900 metra e gjatë dhe me profil 14 metra, dhe është parashikuar e njëjta të jetë e pajisur me sistem për detektimin e incidenteve, zjarreve, sistem për video mbikëqyrje, sistem komunikimi për shfrytëzuesit e shërbimeve urgjente, stacione S.O.S., sisteme për ventilim dhe shenja me përmbajtje të ndryshueshme dhe barriera.

Me ndërtimin e kësaj rruge nëntokësore do të zvogëlohet kohëzgjatja e udhëtimit nga pjesa lindore në atë perëndimore të qytetit, do të rritet shpejtësia e udhëtimit, do të zvogëlohet ndikimi i komunikacionit rrugor mbi ambientin jetësor, do të zvogëlohet zhurma, do të rritet niveli i sigurisë në komunikacionin rrugor, dhe do të zvogëlohen edhe humbjet në kohë në kryqëzime të caktuara.

DO TË NDËRTOHET PLATFORMË ASHENSORI NË QKR

Një nga prioritet kryesorë të Qytetit të Shkupit është realizimi i mbrojtjes sociale të personave me nevoja të veçanta, përkatësisht përmirësimi i kualitetit të jetesës së tyre dhe krijimi i kushteve për një jetë të pavarur. Në këtë drejtim, Këshilli i Qytetit të Shkupit miratoi mjete për furnizimin me një platformë ashensori vertikale dhe një të pjerrët për persona me nevoja të veçanta, në Qendrën kulturore rinore (QKR). Deri tani Qyteti i Shkupit ka ndërtuar rampa hyrëse për persona me nevoja të veçanta në 5 institucione kulturore të qytetit, janë ndërtuar 18 rampa hyrëse për persona me nevoja të veçanta në 12 shkolla të mesme, dhe është vendosur edhe platformë ashensori për persona me nevoja të veçanta në SHMQSH „Mihajlo Pupin“.



TAKIM ME PENSIONISTËT NË QR „KATLANOVË“

Kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski, më 19 tetor vizitoi ambientet e rinovuara të Qendrës rekreative “Katlanovë” që gjendet në Kompleksin e banjave “Katlanovë” dhe që është në pronësi të Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të qytetit të Shkupit. Rinovimi i këtij kompleksi është rezultat i Kontratës së nënshkruar për bashkëpunimin në shumë fusha ndërmjet Qytetit të Shkupit dhe Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të qytetit të Shkupit (LSHP).

- Qyteti i Shkupit, vitin e kaluar nëpërmjet nënshkrimit të Kontratës për bashkëpunim të ndërsjellët me Lidhjen e pensionistëve të qytetit të Shkupit zyrtarizoi përpjekjet për ndihmesën që duhet t’u jepet pensionistëve në avancimin e jetës kulturore, rekreative, sportive dhe edukative, si dhe për realizimin e të drejtave të tjera sociale, të pensionit-invaliditetit dhe të drejtave nga fusha e sigurimit shëndetësor. Në vitin 2011 për rinovimin e pushimores në QR „Katlanovë“ Qyteti i Shkupit nga Buxheti ndau 350 000 denarë, kurse në vitin e ardhshëm në xhiro llogarinë e LSHP-së do të transferohen 500 000 denarë në mënyrë plotësuese, me të cilin do të vazhdojë procesi i çlirimit të hapësirave për rekreacion të pensionistëve – tha kryetari Trajanovski.



Kryetari Trajanovski shfrytëzoi vizitën në pushimore në Katlanovë për t’u njohur me 11-të kryetarët e shoqatave të pensionistëve të Shkupit, të zgjedhur në zgjedhjet e fundit të pensionistëve.

Kryetari i LSHP-së, Krste Andonovski, theksoi se pjesa e rinovuar e ambienteve të pushimores, përkatësisht sallonet në katin e parë dhe të dytë janë shtruar me pllaka, dhe janë rinovuar edhe tualetet në katin e parë.

- Që kur ekziston shoqata jonë, kjo është hera e parë që marrim mjete për rinovimin e

pushimores ku ne qëndrojmë shpesh – theksoi Andonovski.

Qendra për pushim dhe rekreacion është ndërtuar para 30 vjetësh dhe gjendet në Kompleksin e Banjave– Katlanovë. Ka kapacitet prej 60 shtretërish në 30 dhoma dhe mundëson rekreacion komfor dhe të dobishëm për pensionistët. Në Qendër pensionistët mund të shfrytëzojnë edhe shërbime mjekësore të cilat i ofron Banja e Katlanovës. Në Shkup ka rreth 80 000 pensionistë të cilët janë anëtarë të shoqatave të komunave, dhe të gjithë i përkasin Lidhjes së pensionistëve të qytetit.





„KAFJALL NË URË“ 2011

Mbi 2 000 qytetarë më 18 shtator hëngrën mëngjes bashkë dhe u shoqëruan në Urën e gurit në suazat e manifestimit „Kafjall në urë“ që këtë vit u mbajt për herë të dytë. Qyteti i Shkupit organizoi manifestimin për nder të Shën. Marisë së vogël, mbrojtëses së Shkupit.

- Është kënaqësi e veçantë për mua që shikoj se ky manifestim është pranuar nga qytetarët dhe që këtë vit Ju jeni në një numër më të madh. Ky mëngjes i përbashkët, në simbolin e qytetit të Shkupit, Urën e gurit, është dëshmi e kompaktësisë së popullit maqedonas me të gjitha bashkësitë që jetojnë në këto hapësira – theksoi kryetari i Qytetit të Shkupit Koce Trajanovski.

Mysafirët e pranishëm në urë edhe këtë vit i shërbyen nxënësit e shkollës së mesme hoteliere „Llazar Tanev“. Manifestimi „Kafjall në urë“ u përkhrah nga një numër i madh donatorësh, restorantesh, furrash, super-markate, si dhe prodhues dhe importues të ushqimeve dhe pijeve të cilët dhuruan prodhimet e tyre enkas për këtë eveniment.

Manifestimi u pasurua edhe me një numër të madh shfaqjesh nga muzikantët e rrugës.



„TINGUJT E ÇARSHISË“ 2011

Koncertet e muzikës klasike, shfaqjet folklorike të shoqërive kulturore-artistike me renome, orkestrat e muzikës popullore, krijimi i veprave artistike dhe vallëzimi oriental ishin vetëm një pjesë e përmbajtjeve që qytetarëve të Shkupit u ofroi manifestimi kulturor artistik „Tingujt e çarshisë“, i cili u mbajt më 22 shtator në Çarshinë e Vjetër të Shkupit.

Ky manifestim i cili u mbajt këtë vit për të gjashtën herë me radhë në zemrën e Çarshisë së Vjetër të Shkupit, nën organizimin e Qendrës informative kulturore, ka për qëllim që me karakterin e vet multikulturor dhe multimedial të afirmojë dhe animojë Çarshinë dhe të japë impuls plotësues për animimin e sërishëm kulturor të saj nëpërmjet hapjes së portave të artit, kreativitetit dhe zbavitjes.





U MBAJT “NATA E BARDHË” 007

Më shumë se 70 evenimente, ekspozita të ndryshme, koncerte, projeksione filmike, promocione, si dhe spektakël multimedial i atraksionit akrobatik të grupit të njohur në rang botëror GRUPO PUJA shënuan natën më të gjatë kulturore në Shkup - „Nata e bardhë 007” e cila u mbajt më 17 shtator.

Këtë vit, në shumë lokacione nëpër qytet u shfaqën projeksione filmike. Në kinemanë e Qytetit „Milenium” kishte maratonë filmike gjatë gjithë ditës, kurse projeksione në ekran shumë të madh të hapur u shfaqën edhe në Parkun e qytetit. Adhuruesit e fotografisë kishin mundësi të shikonin ekspozitën „Counter photography” të njëmbëdhjetë artistëve bashkëkohorë japonezë në Muzeun e Qytetit të Shkupit, kurse këtë vit për herë të parë u organizua xhiro turistike me biçikletë nëpër monumentet e kulturore historike në qytet me udhëheqës turistik.

Nata e bardhë ishte e mbushur edhe me një numër të madh shfaqjesh muzikore. Në shumë lokacione qytetarët e Shkupit i zbavitnin interpretuesit e rrugës. Në QKR u mbajt zbavitje gjatë gjithë natës që i kushtua muzikantit Dejvid Bouvi, kurse para sheshit të QKR-së koncert mbajtën grupet muzikore „Silicon carne” (Dizhon, Francë), „Fonia” (Shkup) dhe „The glasses” (Prishtinë).

Në suazat e „Nata e bardhë” tradicionalisht u mbajt gara e basketbollit Streetball, ndërmjet ekipeve të përziera të basketbollit të shkollave të mesme të Qytetit të Shkupit.



MOT SHKROI EDHE NJË FAQE NGA HISTORIA JONË TEATRORE

Biletat për Festivalin ndërkombëtar të teatrit „Teatri i ri i hapur“ këtë vit u shitën plotësisht. Në festivalin e 36-të të MOT, për 9-të shfaqje nga pjesa ndërkombëtare e festivalit, 9-të shfaqje vendase, 3 koncerte, 2 promociione librash dhe një instalim kërkohet biletë dhe vend më shumë. Edhe këtë vit seleksionues i programit të festivalit „MOT 007“, që u mbajt nga data 21-28 shtator, ishte regjisori maqedonas Dejan Projkovski.

Festivali u hap me shfaqjen teatrore Turbo Paradizo të Theater Kosztolanyi Deszo, teatër hungarez që punon në Subotica, Serbi. 8-të shfaqjet e tjera ndërkombëtare ishin: Salla e pritjes nga Farm in the Cave Theatre, Çeki; Breht – Makina Hardkor nga Theater Kosztolanyi Deszo, Serbi; Krim dhe dënim nga Mladinsko Theatre, Slloveni; Vallëzimi i fundit nga Mladinsko Theatre Nizhinski, Slloveni; Medeja nga Theatre Studio Eski Masjid, Uzbekistan; Zotërinjtë Glembaj nga Theatre Atelje 212, Serbi; Shpresë, monodramë e Petar Miloshevskit nga Londra dhe shfaqja fituese Romeo dhe Xhulieta nga OKT-Vilnius City, Lituani. Tingujt e kockave që thyhen



nga Teatra teatër; Vapor i për kukulla nga Wonderland teatër; Dashnorja/The Mistress nga teatri Intimate, Metamorfaza nga teatri i Ohrit; Armiku i klasës nga teatri Wonderland; Roberto Zuko nga 11-të teatër; Shërbëtorët nga teatri No Name; Unë, Dua, Zot nga Teatri Buden dhe Pabesi nga teatri CK, ishin dy shfaqjet maqedonase që e pasuruan përmbajtjen e festivalit.

Juria e festivalit përbëhej nga Aleksandra Boshkovska, Xvezda Angelkovska dhe Ljubisha Nikodinovski Bish. Si shfaqje më e mirë nga teatrot e pavarura është zgjedhur Vapor i kukullave i Nela Vitosheviq nga teatri Wonderland, kurse produksioni fitues teatror, sipas votave të publikut, versioni modern i Romeo dhe Xhulieta i teatrit lituanë OKT-Vilnius City, mori shpërblim prej 200 000 denarë për produksionin e shfaqjes së re, që

premierën do ta ketë në festivalin e ardhshëm të MOT.

Në suazat e festivalit u mbajtën edhe dy promociione libri „Teatri i lëvizjes“ nga Jozef Nagj dhe „0,1-Hyrje e shkurtër në përjetësi“ i Zlatko Slavenskit. Në hapjen e festivalit morën pjesë legjendat e artit rok amerikan Tuxedomoon, kurse në mbrëmjet e tjera morën pjesë grupet vendase La Colonie Volvox me mysafirin Teodosij Spasov dhe Bioskopia.

Shfaqjet e huaja u mbajtën në MOB, kinemanë Frosina, MNT dhe në Teatrin dramatik, teatrot e pavarura luajtën shfaqjet e tyre në ambiente jokonvencionale si klube, diskoteka, kabare dhe holle të institucioneve kulturore. Sponsorë të Teatrit të ri të hapur tradicionalisht janë Qyteti i Shkupit dhe Ministria e kulturës, kurse programin e realizoi Qendra kulturore rinore.



MANIFESTIMI PËR FËMIJË „VALLE PA KUFIJ” MBUSHI 20 VJET

Nga data 23 deri më datën 25 shtator qytetarët e Shkupit kishin mundësi të argëtohen me këngët popullore, muzikën, vallet dhe veshjet kombëtare shumë të pasura me të cilat u prezantuan fëmijët nga Polonia, Turqia, Bullgaria, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina dhe nga Maqedonia si pjesë e festivalit më masiv dhe më të vjetër në vendin tonë, „Valle pa kufij”. Festivali është nën organizimin e Qendrës kulturore rinore „Karposh” dhe këtë vit feston jubileun e 20-të.

Ky festival me ekzistimin e tij shumëvjeçar zë një pjesë të rëndësishme në mozaikun kulturor të qytetit tonë. Këta të rinj na drejtojnë mesazhe falënderimi dhe humane për ndërtimin e urave të miqësisë, mirëkuptimit dhe respektimit ndërmjet popujve. Ata janë shembull se si duhet të ndërtojmë botën në të cilën toleranca, krijimtaria dhe qarkullimi i ideve dhe njerëzve duhet të jenë principet themelore mbi të cilat do të bazohet njerëzimi.

Pikërisht këto mesazhe universale që drejton dhe kultivon Festivali ndërkombëtar i fëmijëve „Valle pa kufij” janë ideja themelore e ekzistimit shumëvjeçar dhe të suksesshëm të tij - theksoi kryetari i Qytetit të Shkupit Koce Trajanovski në hapjen e festivalit.

Në 20-të vitet e kaluara nga organizimi i festivalit „Valle pa kufij” Shkupi dhe Maqedonia ishin nikoqirë të mijëra fëmijëve nga vendi dhe jashtë vendit – valltarë.



Për nder të Toshe Proeskit

ULTRAMARATONISTËT ARRITËN EDHE NË SHKUP

Tetëmbëdhjetë atletë maqedonas që morën pjesë në ultramaratonën për nder të Toshe Proeskit—Toshe më 15 tetor arritën edhe në Shkup, kurse në sheshin „Maqedonia” u pritën nga kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce

Trajanovski.

Traseja e pjesëmarrësve në ultramaratonë ka gjatësi 1.100 kilometra nga Nova Gradishka, Kroaci, vendi i fatkeqësisë ku ndërroi jetë Toshe, nëpërmjet Beogradit ku në


mënyrë tradicionale takohen fansat e Toshes nga Serbia, nëpër Shkup deri në vendin e lindjes Krushevë. Kjo ultramaratonë u realizua me iniciativën e Fondacionit „Toshe Proeski”, dhe mbahet në mënyrë tradicionale çdo vit.



SALLA UNIVERSALE FESTOI 45 - VJETORIN E DITËLINDJES

Tereza Kesovija, Igor Xhambazov, Karolina Goçeva, Ansambli i këngëve dhe valleve popullore të Maqedonisë „Tanec“, Violeta Tomovska, dhe Kaliopi ishin vetëm pjesë e artistëve të mirënjohur të cilët më 26 tetor në Sallën universale shënuan 45 - vjetorin e formimit të këtij Institucioni publik nga fusha e kulturës të Qytetit të Shkupit. Manifestimi me rastin e 45 vjetorit të ditëlindjes u mbajt nën moton „Salla universale atëherë, tani dhe përgjithmonë“, kurse të pranishmit kishin mundësi të shikojnë filmin dokumentar me rastin e këtij jubileu.

Menjëherë pas tërmetit katastrofik në Shkup, në vitin 1963, filloi ndërtimi i Sallës universale, si shenjë e përhershme e aksionit human të dhuruesve nga jashtë. Zyrtarisht Salla universale filloi me punë më 1 janar të vitit 1966. Kushtet dhe kapacitetet e shkëlqyera skenike, së bashku me funksionet përcjellëse të objektit dhe vendosja e skenës në formë amfiteatri mundësuan kushte optimale që publiku të ndjekë realizimin e koncerteve të muzikës klasike, zbavitëse, folklorike, etno, bluz, manifestimeve poetike, shfaqjeve dramatike, sfilatave të modës, prezantimeve, kongreseve, këshillimoreve, tribunave, manifestimeve sportive dhe evenimenteve të tjera. Skena e vogël me kapacitet deri në 300 spektatorë, me zgjidhje të plotë akustike, mundëson realizimin e koncerteve të dhomës,



koncerteve të muzikës klasike dhe muzikës xhaz. Hapësira skenike me të cilën disponon salla mundëson shumë variante shfrytëzimi të skenës me sipërfaqe të përgjithshme prej 400 metra katror.

Salla universale disponon me: sallë me kapacitet 1500 spektatorë, plotësisht e zëruar,

park ndriçimi, mundësi për orkestrim, zgjidhje të plota skenike, ambient për ekspozitë. Në Sallën universale janë mbajtur mbi 5000 evenimente të zhanreve të ndryshme, në skenë janë prezantuar rreth 50 000 artistë vendas dhe të huaj, dhe kanë marrë pjesë mbi 7 milion spektatorë.



FESTIVALI NDËRKOMBËTAR I VERËS



Vizitorët e shumtë në Festivalin ndërkombëtar të pestë me radhë „Vino-Skop 2011“ që u mbajt nga data 5 deri më 9 tetor në sheshin „Maqedonia“ kishin mundësi të degustojnë verëra të 30-të kantinave të verës vendase dhe të huaja dhe të zbavitën me programin e pasur muzikor.

- Tradicionalisht, për të pestën herë, Qyteti i Shkupit jep kontributin e tij për promocionin dhe afirmimin e verës tradicionale maqedonase, si para vizitorëve vendas, ashtu edhe para atyre të huaj, kurse bashkimi i traditës dhe inovacionit në industrinë e verës me dashuri të sinqertë për prodhimin e verës mundësuan që të realizohet qëllimi përfundimtar – prodhim i verërave me kualitet me vlerën më të mirë për blerësit – tha kryetari Koce Trajanovski, në hapjen e festivalit.

„VINO-SKOP 2011“



Shitja e prodhimeve në territorin e festivalit u krye vetëm me ashtuquajturit “Denarët e verës” (kupon), që shiteshin në punkte të caktuara, kurse adhuruesit e kësaj pijeje mund të blinin edhe gota speciale me stemën e festivalit. Festivali „Vino-Skop 2011“ u realizua me iniciativën dhe nën patronazhin e Qytetit të Shkupit, kurse organizator profesional është Shoqata për hotelieri dhe tregti „OLD GRIPS PUB“ SH.P.K. Shkup.

FESTIVALI I USHQIMIT ORGANIK



Nën moton „NGA NATYRA PËRMUA“ më 29 tetor në sheshin „Maqedonia“ u mbajt Festivali i ushqimit organik. Qëllimi i manifestimit ishte që të potencojë rëndësia e jashtëzakonshme e prodhimeve natyrale, organike për avancimin e shëndetit të gjeneratave të sotme dhe të ardhshme, por edhe për mirëmbajtjen e biodiversitetit.

Në festivalin njëjavor u prezantuan 30-të prodhues të ushqimit organik nga vendi dhe rajoni, të cilët siguruan ushqim të shijshëm, natyral dhe organik për degustim. Manifestimi është nën organizimin e Qytetit të Shkupit dhe Ministrisë së bujqësisë, pyjeve dhe ekonomisë së ujit, dhe në bashkëpunim me Federatën e prodhuesve të prodhimeve organike të Maqedonisë.





Ditët e artizanatit 2011

MIRËNJOHJE PËR KRYETARIN E QYTETIT TË SHKUPIT TRAJANOVSKI

Në suazat e Ditëve të artizanatit në Republikën e Maqedonisë 2011 më 30 shtator, Dhoma e artizanatit të Shkupit kryetarit të Qytetit të Shkupit i ndau pllakatin për përmirësimin e kushteve të përgjithshme për zhvillimin dhe përparimin e artizanatit.

- Zanatet në qytetin e Shkupit janë zhvilluar nëpër shekuj dhe kanë arritur perfeksionimin e tyre, duke lënë në trashëgimi vlera të përhershme. Me hapjen e punëtorive për trajnim, në të cilat do të mësohen zanatet, edhe në të ardhmen do të përgatiten prodhime që do të jenë bashkim i së vjetrës, tradicionales dhe modernes – deklaroi kryetari Koce Trajanovski në hapjen e manifestimit „Artizanati dhe qyteti i Shkupit në të kaluarën dhe të tashmen”.

Kryetari Koce Trajanovski, rikujtoi edhe një herë projektet e Qytetit të Shkupit për zhvillimin dhe përparimin e artizanatit, siç janë: Formimi i poligonit të qendrave për trajnim, Qendra për industri kreative - Shkup, Qyteti i zanateve të lashta, Qyteti i mjeshtërve të punimeve të dorës, artistëve dhe zanatçinjve, Tingujt e Çarshisë, Panairi i pranverës dhe i Vitit të Ri, Fundjava e lakmuesit, Festivali i verës, Tortijada ndërkombëtare, Festivali i ushqimit organik dhe Muaji i tregtisë



ZGJIDHET OBJEKTI MË I MIRË HOTELIER NË SHKUP

Qyteti i Shkupit vazhdon me traditën dhe për të katërtën herë me radhë në bashkëpunim me agjencinë SWOT Research zgjedhin „Objekti më i mirë hotelier ndërmjet më të mirëve”. Për realizimin e këtij projekti janë zgjedhur 50 restorante dhe 50 bujtina në territorin e Shkupit, kurse do të vlerësohen nga 300 vizitorë, të ashtuquajtur blerës të pavarur dhe objektivë.

Realizimi i projektit, i cili është në vijim, do të zhvillohet në disa faza dhe sipas kriterëve të caktuara: kontakti i parë me mysafirët, pamja e ambientit, shërbimi i kamerierëve, kualiteti i ushqimit dhe kontakti përfundimtar me mysafirët. Mbi bazën e rezultateve të marra nga hulumtimi, do të zgjidhen tre restorantet më të mira dhe tri bujtinat më të mira që kanë arritur rezultatin më të lartë të përgjithshëm të elementeve të hulumtuara. Më të mirëve do

t’u ndahen mirënjohje në formën e pllakatit, që do t’ua ndajë kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski.

Ky projekt realizohet tashmë katër vite me radhë dhe zgjon interes gjithnjë e më të madh tek hotelierët dhe tek qytetarët për rëndësinë e kualitetit të shërbimit, si dhe për ngritjen e nivelit të përgjithshëm të kualitetit të objekteve hoteliere në territorin e qytetit.



HBO центар
NVO center

LOKACIONI:

Qendra kulturore
rinore - QKR
kati I

tel: 02/ 3 222 106

e-mail:

nvocentar@skopje.gov.mk



Shfrytëzim falas i kompjuterëve,
internetit, hapësirës për mbajtjen e
trajnimeve dhe seminareve për OJQ



www.skopje.gov.mk/nvo
Portal falas për
informacionet tuaja

SHPALLEN FITUESIT E ÇMIMIT „13 NËNTORI“ PËR VITIN 2011

Këshilli drejtues i Çmimit „13 Nëntori“ të Qytetit të Shkupit për vitin 2011 vendosi çmimin prestigjioz për individë dhe grup krijuesish t'ua ndajë:

- Nga fusha e shkencës - dr. Nikita Shekutkovski
- Nga fusha e arsimit dhe edukimit - prof. dr. Ljubinka Basotova
- Nga fusha e artit – Fejzi Bojku dhe Dimitar Masevski
- Nga fusha e publicistikës – Boris Pop Gjorçev
- Nga fusha e sportit - Boshko Zaborski
- Nga fusha e aktiviteteve humanitare – Aleksandar Janevski
- Nga fusha e ekonomisë – Miço Popovski

Çmimin „13 Nëntori“ të Qytetit të Shkupit në vitin 2011 për persona juridikë e mori Shoqata „Qendra për hulumtimin dhe informimin për ambientin jetësor „Eko-Svest“, kurse Ivan Antonovski, Tasko Smileski dhe Aleksandar Stepanovski janë nxënësit dhe studentët e sivjetmë, fitues të këtij çmimi të njohur të qytetit.

Çmimet laureatëve të sivjetmë do t'u ndahen në manifestimin solemn që tradicionalisht mbahet në Ditën e çlirimit të Shkupit.



U kremtua dita ndërkombëtare pa automobila, 22 shtatori JAVA EVROPIANE E MOBILITETIT EDHE NË SHKUP

Qyteti i Shkupit kremtoi Ditën ndërkombëtare pa automobila, 22 shtatorin dhe përfundoi aktivitetet që u organizuan me rastin e Javës evropiane të mobilitetit 2011 (nga data 16 deri më datën 22 shtator). Parada e këmbësorëve dhe çiklistëve më 22 shtator filloi pasdite nga shatërvani „Lulja e zambakut“ në Parkun e qytetit dhe lëvizte nëpër rrugët e qendrës së qytetit deri në sheshin „Maqedonia“.

- Këtë vit Qyteti i Shkupit iu bashkua familjes së madhe të qyteteve evropiane të cilët çdo vit organizojnë fushatën më të përhapur për mobilitet të qëndrueshëm – Java evropiane e mobilitetit në të cilën janë anëtarë dhe janë aktivë disa mijëra qytete nga Evropa me mbi 220 milion banorë. Motoja e javës së sivjetme „Mobiliteti alternativ“ tregon për qëllimet ambicioze që Bashkimi evropian

i vendosi para vendeve anëtare, të cilat duhet të plotësohen deri në vitin 2020. Ato kanë të bëjnë me zvogëlimin e emisionit të gazrave të qelqtë, rritjen e efikasitetit energjetik dhe shfrytëzimin më të madh të burimeve ripërtëritëse të energjisë. Qyteti i Shkupit është më i përgatituri për pjesëmarrje në një manifestim të tillë të madh dhe ka me çfarë të paraqitet para publikut evropian. Këtu, para së gjithash, mendoj për ndryshimet e mëdha pozitive në transportin publik urban, siç janë blerja e 149 autobusëve të rinj, linja e re e autobusit deri në Vodnon e mesme, projekti për rinovimin e 290 stacioneve të autobusit, vendosja e dotacioneve për nxënësit, transporti falas për pensionistët etj. Motorët e autobusëve janë me standarde EURO 4 dhe EURO 5 gjë me të cilën ndikojmë drejtpërsëdrejti mbi kualitetin e ajrit në qytet. Kontribut të veçantë





për mbrojtjen e ambientit jetësor ka edhe teleferiku deri te Kryqi i mileniumit— sqaroi kryetari Trajanovski.

Qyteti i Shkupit në periudhën që kaloi punoi në mënyrë intensive në përmirësimin e kushteve në qytet për shfrytëzimin e biçikletave.

- Me kënaqësi të veçantë theksoj angazhimin e Qytetit të Shkupit në mundësitë e krijuara për transport të organizuar për personat me handicap, që ishin pjesë e paradës dhe të cilëve u ishin kushtuar aktivitete në një nga ditët e Javës evropiane të mobilitetit, nën moton „Edhe unë lëviz pa automobil, nëse më jep mundësi“. U bëj thirrje qytetarëve të shfrytëzojnë transportin publik dhe të

pranojnë moton „Në qytet pa automobilin tim“, gjë me të cilën do të japin kontribut personal për mbrojtjen e ambientit jetësor— shtoi kryetari Trajanovski.

Në suazat e shtatë ditëve të Javës evropiane të mobilitetit Qyteti i Shkupit organizoi një numër të madh aktivitete të cilat ishin në funksion të promocionit të transportit publik, të transportit me biçikletë, u promovuan mundësitë për turizëm ditor në lokalitetet e mbrojtura natyrore, u arsimuan të rinjtë dhe iu ndanë këshilla nga fusha e jetës së shëndetshme, u fol për ndikimin e komunikacionit mbi ambientin jetësor, për shpenzimin energjetik në fushën e komunikacionit, përkatësisht për mundësitë

për arritjen e efikasitetit energjetik në komunikacionin rrugor, për aktivitetet për mbrojtjen e ozonit, për ndihmën që duhet t'u jepet personave me vështirësi në lëvizje dhe shumë aktivitete të tjera.

Gjatë gjashtë ditëve të javës së mobilitetit u ndanë 1 000 kuponë shpërblyes për shoferët e automjeteve motorike për transport falas në autobusët e qytetit më 22 shtator. Kuponët shpërblyes të plotësuar morën pjesë në lojën shpërblyese në të cilën u ndanë pesë biçikleta, 50 bileta-bloke me dhjetë udhëtime falas në autobusët e NQP-së, si dhe 100 çmime – bileta për shfrytëzimin falas gjatë gjithë ditës të biçikletave që huazohen në punktet për biçikleta.



„SHKUP“

LAJMËTARI INFORMATIV I
QYTETIT TË SHKUPIT

Numri i parë i lajmëtarit informativ
„Shkupi“ u botua më:
10 dhjetor 2008

Kryeredaktor

Nedelço Krstevski

Redaksia

Seksioni për marrëdhënie me
opinionin

Redaktor i fotografi së

Radomir Jovanović

Përkthyes dhe lektor

Vladimir Bogdanovski

BOTON QYTETI I SHKUPIT

për botuesin

Kryetari i Qytetit

Koce Trajanovski

Bulevardi Ilindenska p.n.

Telefon

02 3297 255

e-mail adresa

gragjani@skopje.gov.mk

Dizajni

NAMPRES - Shkup

Botoi

NAMPRES - Shkup



Ura "Goce Delçev"